

L I G J
Nr.7811, datë 12.4.1994

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.782, DATË 22.2.1994 “PËR
SISTEMIN FISKAL NË SEKTORIN E HIDROKARBUREVE (KËRKIM-PRODHIM)”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të miratojë dekretin nr.782, datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)” me këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i nenit 1 të dekretit të formulohet:

“Kontraktuesi detyrohet të paguajë në çdo vit fiskal vetëm tatimin mbi fitimin e realizuar në atë vit fiskal. Tatimi mbi fitimin mund të tërhiqet në natyrë a në para, ose në formë të përzier, siç mund të parashikohet në çdo marrëveshje hidrokarburesh.”

2. Paragrafi i dytë i nenit 3 të formulohet:

“Gjithashtu, trajtohen njëjloj si në paragrafin e mësipërm të këtij neni edhe sendet e përdorimit vetjak të punonjësve të huaj, të kontraktuesit e nënkontraktuesve të tij, që lidhen me operacionet e hidrokarbureve”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.825, datë 20.4.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha